

## KONTRATE PERFUNDIMTARE TRANSFERIM KUOTASH

Sot, me date 30.06.2023, ne Tirane, Palet e meposhtme lidhin kete kontrate perfundimtare per transferimin e kuotave (me poshte e quajtur "Kontrata"):

**Trimed Shpk.**, nje shoqeri e organizuar dhe qe ekziston sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, e regjistruar me Regjistrin Tregtar me numer biznesi K51612031J, dhe me seli ne adresen Autostrada Tirane -Durres, Km 10, Zone Kadastrale 2105, Nr. Pasurie 95/11, perfaqesuar nga administratorja Znj. Gentiana Peshkatari ("**Trimed**" ose "**Bleresi**")

dhe

**Z. Edmond Hido**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 20.08.1956, mbajtes i leternjoftimit me nr. 035089882 ("**Shitesi**") si dhe Znj. Majlinda Hido, shtetase shqiptare, lindur ne Tirane, me 04.05.1958, mbajtese e leternjoftimit me nr. 035047651, ne cilesine e bashkshortes se Shitesit dhe dheneses se pelqimit per transferimin e shitjes se kuotave.

Palet do te quhen secila "Pala" dhe bashkerisht "Palet".

### MEQENESE

- A. Shitesi eshte ortak i vetem i shoqerise **Riofarma Shpk.** nje shoqeri e organizuar dhe qe ekziston sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, e regjistruar me Regjistrin Tregtar me numer biznesi J61817032C, dhe me seli ne adresen Katund i Ri, Autostrada Tirane-Durres, Rruga Dytesore, Km 9 ("**Riofarma**" ose "**Target**").
- B. Shitesi zoteron 100 kuota qe perfaqesojne 100% te kapitalit te Riofarma, me nje vlere totale 40.273.796 Leke ("**Kuotat**").
- C. Bleresi dhe Shitesi kane shprehur vullnetin qe Bleresi te bleje Kuotat sipas kushteve te kesaj kontrate.

Sa me siper, Palet, me marreveshje, me vullnetin e tyre te lire, bien dakord si vijon:

### NENI 1 - Objekti

1. Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Shitesi i transferon Bleresit Kuotat.
2. Bleresi fiton titullin e pronesise mbi Kuotat ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate.
3. Si pasoje e transferimit te titullit te pronesise se Kuotes, Bleresi behet ortak i Shoqerise duke zoteruar Kuotat dhe ka te drejte te regjistroje dhe depozitoje pronesine e tij mbi Kuotat prane Regjistrin Tregtar dhe Qendres Kombetare te Biznesit si dhe te perfitoje te gjitha te drejtat e votes dhe te dividendit, perfshire dividendin e pashperndare dhe/ose te shperndare por te papaguar.
4. Sa me siper bazuar edhe ne nenin 73.2 te ligjit 9901 "Per shoqerite tregtare" sipas te cilit kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuoten si dhe kushtet e tjera, perfshire momentin e pageses se cmimit rregullohen nga kontrata e transferimit te kuotes. Vlefshmeria e kalimit te titullit te pronesise mbi kuotat nuk do te kushtezohet nga kryerja e formaliteteve te ndryshme me efekt deklarativ.

### NENI 3 – Cmimi

Palet bien dakord se cmimi i shitjes se Kuotave eshte ne shumen 40.273.796 Leke (“Cmimi i Shitjes”). Ky cmim do te paguhet brenda 90 ditesh nga kerkesa e Shitesit sipas planit bashkengjitur. Pagesa e cmimit eshte e vecante dhe e ndare nga momenti i transferimit te titullit te pronesise mbi Kuotat dhe Palet bien shprehimisht dakord, sic e lejon edhe neni 73.2 i ligjit “Per shoqerite tregtare”, qe pagesa e cmimit te kryhet pasi eshte transferuar titulli i pronesise mbi Kuotat nga Shitesi tek Bleresi. Bazuar ne nenin 73.2 te siperpermendur, mospagesa ne momentin e depozitimit te ndryshimit te ortakut te Shoqerise nga Shitesi tek Bleresi nuk duhet te jete pengese per depozitim dhe transferimin e titullit te pronesise te Kuotave tek Bleresi.

### NENI 4 – Ligji i Zbatueshem dhe zgjidhja e mosmarreshjeve

1. Kjo Kontrate rregullohet nga legjislacioni shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete Kontrate, zbatohen ne vecanti dispozitat e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.
2. Mosmarreshjet qe mund te lindin ndermjet Paleve nga kjo, apo ne lidhje me kete Kontrate do te zgjidhen me mirekuptim midis tyre. Ne rast te kundert, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.
3. Kontrata e nenshkruar nga Palet me date 28.09.2022 eshte plotesuese e kesaj Kontrate persa nuk vjen ne kundershtrim me kete Kontrate.

Kjo Kontrate eshte hartuar ne 2 (dy) kopje origjinale ne gjuhen shqipe, te gjitha te nenshkruara nga Palet dhe me vleren e njeje ligjore dhe hyn ne fuqi qe nga momenti i nenshkrimit te saj.

RIO - FARMA  ALBANIA

SHITESI

TEL +355 4 221 956


FAX +355 4 222 235

  
Edmond Hido



Znj. Majlinda Hido

BLERESI

  
Trimed Shpk.  
Perfaqesuar nga Znj. Gentiana Peshkatari

Ne cilesine e bashkshortes se Shitesit dhe dheneses se pelqimit per realizimin e transakcionit objekt i kesaj Kontrate

## PLANI I PAGESES SE CMIMIT TE SHITJES

Palet bien dakord qe plani i pageses se cmimit te shitjes se Kuotave te Riofarma Shpk., te jete si vijon:

Kesti	Shuma e Kestit	Periudha
Kesti 1	1,000,000	Tetor 2023
Kesti 2	5,000,000	Mars 2024
Kesti 3	5,000,000	Qershor 2024
Kesti 4	7,000,000	Tetor 2024
Kesti 5	6,000,000	Janar 2025
Kesti 6	8,136,898	Qershor 2025
Kesti 7	8,136,898	Tetor 2025

